



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 16/09/2022, Ref.: 1516/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.15/2018, datë 28.09.2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe vendimin e Komisionit të ankesave KA.NR.1069/22 datë 15.08.2022, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 104-të mbajtur më 01.09.2022, mori:

V E N D I M

- I. Ndryshohet vendimi nr.Ref:3022/21 datë 12.08.2021, në paragrafin I, në pikën e parë, për programin Shkenca kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc 180 ECTS, maksimum 160 studentë për vit akademik, **(zgjatet afati i riakreditimit nga tri (3) vite sa ishte me këtë vendim, në pesë (5) vite 01 tetor 2021 - 30 shtator 2026).**
- II. Pjesa tjetër e vendimit mbetet e pa ndryshuar.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Universiteti i Mitrovicës – Fakulteti Juridik në afatin ligjor kishte parashtruar ankesë me nr.3182/21H të pranuar me datë 10.09.2021, kundër vendimit të KSHC nr. Ref:3022/21 të nxjerrë me datë 12.08.2021 me të cilin riakreditohet programi Juridik, LLB, 240 ECTS, maksimum 80 studentë për vit akademik.

Ankuesi në ankesë pretendon se KShC me vendimin Nr.Ref:3022/21, datë 12.08.2021 ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të nenit 18 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018, datë 28.09.2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës.

KShC pas pranimit të ankesës, bazuar në nenin 131 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pa u shprehur mbi të, të njëjtën e ka përcjellë në Komisionin e ankesave të AKA.

KShC me Vendimin Nr.Ref:3022/21, datë 12.08.2021, ka arsyetuar se është akredituar programi; Për programin e studimit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS.

Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim dhe riakreditim të programeve të studimit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS (Riakreditim) me stafin akademik (bartësit) Artan Rexhep, Muzafer Shala dhe Faton Merovci.

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit, AKA ka organizuar vizitat në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”, në datat 11.02.2021, 25.02.2021 dhe 22.03.2021 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Damir Kalpic, Tauno Otto, Bettie Higgs, Regita Bendikiene, Janez Krek, Janez Vogrinc, Peter Parycek, Dietmar Paier, Mikus Dubickis, Asnate Kazoka, Marija Vasilevska.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit, dhe për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. *Për programin e studimit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS, - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë substancialisht gjashtë (6) dhe pjesërisht një (1) prej tyre.*

Komisioni i Ankesave, pas mbledhjes konstitutive të mbajtur me datë 09.06.2022 njëzëri ka vendosur që të shqyrtoj të gjitha ankesat e parashtruara nga IAL-të për periudhën sa nuk ishte funksional.

Komisioni i ankesave i AKA-së gjatë shqyrtimit të ankesës ka administruar provat si:

- Ankesë kundër vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë nr.:3139/21H, dt. 02.09.2021
- Vendimi i Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC), Nr.Ref:3039/21, datë 12.08.2021
- Raporti i Ekipit të Ekspertëve të datës 02.04.2021,
- Raporti përmbledhës i KShC-së për ankesën

Pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të lartcekura komisioni ka gjetur se në Reportin e Ekipit të Ekspertëve të datës 02.04.2021, ne rekomandimin përfundimtar, ekspertët rekomandojnë akreditimin e programit si vijon; *“In conclusion, the Expert Team considers that the study programme Computer Science and Engineering, BSc, offered by University of Mitrovica, Faculty of Mechanical Engineering and Computing is Substantially compliant, with the standards included in the KAA Accreditation manual and, therefore, recommends to accredit the study program for a duration of 5 years with a number of 160 students to be enrolled in the program”.*

Komisioni i Ankesave i AKA-së pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave dhe provave të lëndës, pretendimeve të palës ankuese, ka gjetur se ankesa e ankuesit është e bazuar dhe se KShC-së me Vendimin i Nr.Ref:3039/21, datë 12.08.2021 me të cilin;

Riakreditohen programet e studimit të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, për periudhën tri (3) vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:

- Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS, maksimumi 160 studentë për vit akademik. nuk ka aplikuar drejtë nenin 18, paragrafi 2 dhe nenin 19, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 15/2018, me ç'rast Komisioni i ankesave konstatoi se referuar raporteve të lartcekura janë plotësuar kushtet për **Riakreditim për programin e studimeve të lartcekura për periudhën pesë (5) vjeçare**, jo siç ishte përcaktuar në vendimin e KShC-së për periudhën tre (3) vjeçare.

KShC pas pranimit të vendimit të komisionit të ankesave të AKA-së KA.NR.1071/22 datë 15.08.2022, me propozimin për ndryshim të vendimit Nr.Ref:3035/21, të datës 12.08.2021, në mbledhjen 104 të mbajtur me datë 01.09.2022 ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të filloj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore Prishtinë-Departamenti për çështje administrative. Padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Mitrovicës
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasni Halazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë